**RAPORT VLERESIMI**

**PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE "QENDRA TREGTARE DHE ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k. TIRANE.**

Une, Artan Golemi, Ekspert Kontabel i Autorizuar me Liçense Nr.80, jam emeruar nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise " Qendra Tregtare dhe Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane , te mbledhur me date 25 Gusht 2004, per kryerjen e misionit per zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

Mbeshtetur ne ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" ,nenet 40, 41 e 62 kam kryer misionin tim per vleresimin e kapitalit te shoqerise.

Per kryerjen e misionit kam shfrytezuar:

1. Bilancin financiar se bashku me anekset e tij, te shoqerise " Qendra Tregtare dhe Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane , te vitit 2004 shoqeruar me raportin e ekspertit kontabel te autorizuar per miratimin ligjor te llogarive.
2. Dokumentacionin ligjor te krijimit te shoqerise " Qendra Tregtare dhe Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane .

Kontrolli u krye ne seline e shoqerise ku hartohen bilancet dhe dokumentat kontable, ku na u dhane shpjegime dhe justifikime plotesuese per elementet e bilanceve te shqyrtuara.
Shoqeria "Qendra Tregetare dhe e Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. me seli ne Tirane, eshte rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Tirane me Nr. I aktit 6730 date 15.09.1993 si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ndryshuar me Nr. Akti 6730/2 dhe 6730/3 date 23/09/1998.

Sipas nenit 8 te Statutit te shoqerise dhe Aktit te Themelimit, Kapitali I Shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane eshte 291.500.000 leke e ndare me pjesmarje si me poshte.:

| | |
|---|---|
| TECNOSYSTEM ENGINEERING S.r.l. | 40% e barabarte me 116.275.000 leke |
| SIMEST S.p.A. | 15% e barabarte me 43.725.000 leke |
| MINISTRIA E KULTURES, RINIS E SPORTEVE (kap.shtet) | 45% e barabarte me 131.500.000 leke |
| Gjithsej | 291.500.000 leke |

Sipas vendimit te dates 25.08.2004 te mbledhjes se asamblese se ortakeve te shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane eshte vendosur modifikimi ne nenin 8 te statutit ne pakesim te vleres se kapitalit themeltar nga shuma 291,500,000 leke behet 291,265,262 leke duke mos ndryshuar kuotat e pjesemarrjes ne perqindje qe secili ortak ka ne kapitalin e shoqerise.Ky ndryshim ne zvogelim te kapitalit eshte si rezultat i ndryshimit te vleres se kuotes shteterore qe nga 131,500,000 leke behet 131,265,262 leke mbasi siperfaqja e terrenit ndryshon nga 10,000 m2 ne 4 411 m2, te shpjeguar ne relacionin teknik, ne perkatesi te shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane. Siperfaqja e truallit ne pronesi te "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane perbehet nga 2700 m2 siperfaqe oborri dhe 1711 m2 siperaqe tereni mbi te cilen ndodhet ndertesa ne pronesi te "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" sh.p.k. Tirane. Si rezultat i zvogelimit te siperfaqes te truallit ne pronesi te shoqerise vleresimi i truallit qe mbetet ne kuotat e kapitalit shteteror eshte 185,262 leke nga vlera prej 420,000 leke qe i referohet aktit te themelimit duke zvogeluar kapitalin themeltar nga 291,500,000 leke ne 291,265,262 leke.

**PERFUNDIM**

Ne perfundim te misionit tim jam ne gjendje te vertetoj se duke patur parasysh hollesite e dhena me siper te cmoj se vlerat e kapitalit themeltar , mbas ndryshimeve te bera ne zvogelim, te arrijne shumen 291,265,262 leke.

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

ARTAN GOLEMI

Nr. Liçense 80

Tirane,me 25.08.2004

Eksperti Kontabël Autorizuar
ARTAN GOLEMI
TIRANË ALBANIA

# PROCES VERBAL I ASEMBLESE SE ORTAKEVE

Sot me date 25 Gusht 2004, ne oren 18.00, ne Tirane, ne seline ligjore te saj sheshi Skenderbej, u mblodh Asambleja e Ortakeve e shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor"- Sh.p.k..
Te pranishem ne mbledhje jane:

- TECNOSYSTEM ENGINEERING S.r.l, zoteruese e 40% te kapitalit te shoqerise, e perfaqesuar ne baze te prokures perkatese nga z. Vincenzo Pastoressa,
- SIMEST S.p.A. zoteruese e 15% te kapitalit te shoqerise, e perfaqesuar ne baze te prokures perkatese nga z. Vincenzo Pastoressa,
- MINISTRIA E KULTURES RINISE E SPORTEVE, zoteruese e 45% te kapitalit te shoqerise, e perfaqesuar nga z. Agim Bajko,
- Eksperti kontabel i autorizuar z. Artan GOLEMI.

Asambleja e Ortakeve mori ne shqyrtim rendin e dites:

1) Ndryshimin, zvogelimin e siperfaqes se truallit ne pronesi te shoqerise duke zvogeluar keshtu vlerën ë kapitalit themeltar te Shoqerise
2) Caktimin e ekspertit kontabel te autorizuar per ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise, dhe miratimi i aktit te tij.
3) Të ndryshme

Formalizohet pjesemarrja ne mbledhje e ortakeve qe perfaqesojne te gjithe kapitalin e shoqerise " Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" Sh.p.k, regjistruar prane Gjykates se Tiranes me Vendimin nr. 6730 date 15.09.1993.
Drejtues i mbledhjes eshte Presidenti z. Vincenzo PASTORESSA, i cili pasi verifikoi thirrjen e rregullt te kesaj mbledhje si dhe kuorumin vendimarres, parashtroi se:
Kapitali themeltar i shoqerise ne momentin e krijimit si kapital ne nature te ortakut shteteror me kuotat perkatese ishte 131.500.000 Leke ku perfshiheshin elementet si me poshte:

1. Vleresimi e Nderteses, Vlera e mjeteve te tjera Kryesore………………… 131.080.000 leke
2. Vleresimi i truallit i referuar 10.000 m2 siperfaqe……………………………… 420.000 leke

Vlera totale e kuotes shteterore……………………………………………… 131.500.000 leke

Nga verifikimi faktik shoqeria ka konstatuar se ka ne administrim dhe posedim njekohesisht nje siperfaqe trualli me te vogel se ajo e percaktuar ne dokumentat e themelimit te saj , pra lind nevoja e rregullimit, e percaktimit te sakte te siperfaqes se truallit ne pronesi te shoqerise.
Eshte arritur ne kete perfundim, ne Relacionin Teknik te dates 10.08.2004 te perpiluar nga ing. Luigj ALEKSI me nr. K 0122 license, me kerkesen e shoqerise. Ne baze te ketij akti siperfaqa e truallit ne pronesi te shoqerise nga 10 000 m2 eshte realisht 4 411m2, nga e cila 2 700 m2 siperfaqe e oborrit te brendshem dhe 1 711 m2 siperfaqe trualli mbi te cilen ndodhet ndertesa ne pronesi te shoqerise.
Duke qene se ky rregullim do te reflektohet dhe ne vleren e kapitalit themeltar, per te realizuar kete operacion lidhur me ndryshimin e vleres se tij, gjithmone pa u ndryshuar kuotat e ortakeve mbledhja unanimisht caktoi ekspert kontabel te autorizuar (prezent) z. Artan GOLEMI me nr. 80 license, per hartimin e ketij akti, duke ju vene njokehesisht ne dispozicion menjehere i gjithe dokumentacioni i nevojshem ne menyre qe te realizoje perpilimin e tij gjate kohes qe mbledhja do te vazhdoje lidhur me ceshtjet e tjera. dhe ta miratoj ate. Ne fund te mbledhjes eksperti kontabel i autorizuar z. Artan GOLEMI, paraqiti per miratim raportin e vleresimit lidhur me ndryshimin,

zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise. Ortaket pasi diskutuan ne parim vendosen qe ta miratojne ate, duke bere keshtu dhe ndryshimet perkatese te nenit 8 te statutit.
Ne perfundim te saj, mbledhja e Asamblese se Ortakeve unanimisht,

**VENDOSI**

1. Caktimin si ekspert kontabel te autorizuar, zotin Artan GOLEMI, me nr. 80 license si dhe miratimin e raportit te vleresimit dt. 25.08.2004 per ndryshimin, zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise, te paraqitur nga ky ekspert.
2. Ndryshimin e siperfaqes se truallit ne pronesi te shoqerise e cila nga 10 000 m2 (si siperfaqe jo faktike ne administrim dhe posedim te shoqerise) behet 4 411 m2, nga e cila 2 700 m2 siperfaqe e oborrit te brendshem dhe 1 711 m2 siperfaqe trualli mbi te cilen ndodhet ndertesa ne pronesi te shoqerise. Ndryshimin ne art.8 te Statutit, te vleres se kapitalit te shoqerise, e cila nga 291 500 000 leke zvogelohet ne 291 265 262 leke.
3. Te behet perpilohet vendimi perkates per kete mbledhje dhe depozitimi i tij ne regjistrin Tregtar te Gjykates Shkalles Pare Tirane.
4. Procesverbali mbahet ne 5 kopje te barazvlefshme.

Duke mos patur gje tjeter per te vendosur dhe pasi askush nuk e kerkoi fjalen, Presidenti ne oren 21.00 e deklaron të mbyllur mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve pasi është lexuar paraprakisht dhe të pranishmit kanë firmosur proçes verbalin e mbledhjes.

Kryetari: Vincenzo Pastoressa ____________________

Ortaket:

Tecnosystem Engineering S.r.l. ____________________

Simest S.p.A. ____________________

Ministria e Kultures Rinise dhe Sporteve ____________________

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
Nr. 6730/19 Regj.

## VENDIM
### I GJYQTARIT TE VETEM

Sot ne Tirane, me 17 . 09.2004, une Gjyqtari i vetem M. D... prane Gjykates Shkalles Pare Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Administratori i shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" SH.P.K me dokumentacionin bashkangjitur:

## KONSTATOVA

Se ne mbledhjen e dates 25.08.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor " SH.P.K eshte marre vendimi ne te cilin eshte vendosur:

1. Caktimi si ekspert kontabel i autorizuar zotit Artan GOLEMI me nr.80 licence, si dhe miratimi i raportit te vleresimit dt. 25.08.2004 per ndryshimin, zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise, te paraqitur nga ky ekspert.
2. Ndryshimi i siperfaqes se truallit ne pronesi te shoqerise e cila nga 10 000 m2 (si siperfaqe jo faktike ne administrim dhe posedim te shoqerise) behet 4 411 m2, nga e cila 2 700 m2 siperfaqe e oborrit te brendshem dhe 1 711 m2 siperfaqe trualli mbi te cilen ndodhet ndertesa ne pronesi te shoqerise. Ndryshimin ne art.8 te Statutit, te vleres se kapitalit te shoqerise e cila nga 291 500 000 leke zvogelohet ne 291 265 262 leke.
3. Depozitimi I ketij vendimi ne Regjistrin Tregtar te Gjykates Shkalles Pare Tirane.
4. Vendimi te perpilohet ne 5 kopje te barazvlefshme.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " dhe nenit 24 e 33 te ligjit Nr. 7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses se administratorit te shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor " SH.P.K per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit te Asamblese se Ortakeve date 25.08.2004 ne te cilin eshte vendosur:

- Caktimi si ekspert kontabel i autorizuar zotit Artan GOLEMI me nr.80 licence, si dhe miratimi i raportit te vleresimit dt. 25.08.2004 per ndryshimin, zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise, te paraqitur nga ky ekspert.
- Ndryshimi i siperfaqes se truallit ne pronesi te shoqerise e cila nga 10 000 m2 (si siperfaqe jo faktike ne administrim dhe posedim te shoqerise) behet 4 411 m2, nga e cila 2 700 m2 siperfaqe e oborrit te brendshem dhe 1 711 m2 siperfaqe trualli mbi te cilen ndodhet ndertesa ne pronesi te shoqerise. Ndryshimin ne art.8

te Statutit, te vleres se kapitalit te shoqerise e cila nga 291 500 000 leke zvogelohet ne 291 265 262 leke.

- Depozitimi I ketij vendimi ne Regjistrin Tregtar te Gjykates Shkalles Pare Tirane.
- Vendimi te perpilohet ne 5 kopje te barazvlefshme

Te behen ndryshimet ne kollonen 4 te Regjistrit Tregtar. Te behet ndarja me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

GJYQTARI

**VENDIM**

**I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**
**TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**QENDRA TREGTARE DHE E ZHVILLIMIT KULTUROR SH.P.K.**

Sot me date 29 Tetor 2004, ne oren 12.00, ne Tirane, ne seline ligjore te saj ne sheshi Skenderbej, u mblodh Asambleja e Ortakeve e shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" Sh.p.k.
Te pranishem ne mbledhje jane:

- TECNOSYSTEM ENGINEERING S.r.l, zoteruese e 40% te kapitalit te shoqerise, e perfaqesuar ne baze te prokures perkatese nga z. Vincenzo Pastoressa,
- SIMEST S.p.a, zoteruese e 15% te kapitalit te shoqerise e perfaqesuar ne baze te prokures perkatese nga z. Vincenzo Pastoressa,
- MINISTRIA E KULTURES RINISE E SPORTEVE, zoteruese e 45% te kapitalit te shoqerise, e perfaqesuar nga z. Agim Bajko,

Asambleja e Ortakeve eshte mbledhur ne baze te kerkeses date 19.10.2004 te perfaqesuesit te ortakut shteteror "MINISTRIA E KULTURES RINISE E SPORTEVE" dhe mori ne shqyrtim rendin e dites te paracaktuar:

1. Revokimi i vendimit date 25.08.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise. Kthimi ne gjendjen e meparshme te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Të ndryshme

Formalizohet pjesemarrja ne mbledhje e ortakeve qe perfaqesojne te gjithe kapitalin e shoqerise " Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" Sh.p.k, regjistruar prane Gjykates se Tiranes me Vendimin nr. 6730 date 15.09.1993.
Drejtues i mbledhjes eshte Presidenti z. Vincenzo PASTORESSA, i cili pasi verifikoi thirrjen e rregullt te kesaj mbledhje si dhe kuorumin vendimarres, e deklaroi mbledhjen e hapur dhe lidhur ceshtjen e parashtruar ne rendin e dites parashtroi se:
Asamblese i eshte paraqitur nje kerkese date 19.10.2004 nga perfaqesuesi i ortakut shteteror "MINISTRIA E KULTURES RINISE E SPORTEVE" zoteruese e 45% te kapitalit te shoqerise, per revokimin e vendimit date 25.08.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise pasi eshte konstatuar se nga ky vendim si dhe akti i ekspertimit i po kesaj date i kryer nga eksperti kontabel i autorizuar Artan GOLEMI, jane cenuar interesat e shtetit pasi eshte zvogeluar vlera e kuotes shteterore ne shoqerine "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" Sh.p.k. Pas diskutimit ne parim midis ortakeve, kerkesa e paraqitur nga perfaqesuesi i ortakut shteteror eshte gjetur e drejte dhe eshte miratuar nga asambleja.

Pas perfundimit te diskutimit ne parim te ceshtjes se marre ne shqyrtim sipas rendit te dites, duke mos pasur asgje per te shtuar, mbledhja e Asambleja e Ortakeve ne unanimitet,

**VENDOSI**

1. Revokimin e vendimit date 25.08.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise. Kthimi ne gjendjen e meparshme te kapitalit themeltar te shoqerise.

- Vendimi te perpilohet ne 4 ekzemplare te barazvlefshem.
- Te behet depozitimi i ketij vendimi ne regjistrin Tregtar te Gjykates Shkalles Pare Tirane.

ORTAKET

Tecnosystem Engineering S.r.l. ____________

Simest S.p.A. ____________

Ministria e Kultures Rinise dhe Sporteve ____________

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr 2671 Rep
Nr 613 Kol

VERTETIM

Sot ne Tirane, me date 03-11-2004 .2004 (Dy mije e kater), para meje noterit Andon Pano, Anetar i dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten ortaket e shoqerise "QENDRA TREGTARE DHE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k:

-Vincenzo PASTORESSA, i dtl. 23.02.1964, shtetas italian, lindur dhe banues ne Bitonto rruga "Mateotti", nr. 181, madhor, i panjohur me pare personalisht prej meje, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te pasaportes me nr. Y085243, perfaqesues i shoqerive "TEKNOSYSTEM ENGINEERING"s.r.l dhe "SIMEST" s.p.a.

-Agim BAJKO, i dtl. 10.02.1956, shtetas shqiptar, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, i panjohur me pare personalisht prej meje, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te pasaportes me nr. 1508954, perfaqesues i Ministrise se Kultures Rinise dhe Sporteve,

te cilet me deklaruan se jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tyre te plote kane marre kete **VENDIM** te Asamblese se ortakeve te shoqerise "QENDRA TREGTARE DHE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k, te cilin une ia lexoj dhe e nenshkruajne ate rregullisht para meje dhe une e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

NOTER
ANDON PANO

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
Nr 6370/10 Regj.

## VENDIM
### I GJYQTARIT TE VETEM

Sot ne Tirane, me 9 .11.2004, une Gjyqtari i vetem M. Dogjo prane Gjykates Shkalles Pare Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Administratori i shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor" SH.P.K me dokumentacionin bashkangjitur:

### KONSTATOVA

Se ne mbledhjen e dates 29.10.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor " SH.P.K eshte marre vendimi ne te cilin eshte vendosur:

- Revokimi i vendimit date 25.08.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise. Kthimi i kapitalit ne vleren dhe masen qe gjendej para mbledhjes se asamblese se ortakeve date 25.08.2004.

### PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " dhe nenit 24 e 33 te ligjit Nr. 7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

### VENDOSA

Pranimin e kerkeses se administratorit te shoqerise "Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor " SH.P.K per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit te Asamblese se Ortakeve date 29.10.2004 ne te cilin eshte vendosur:

- Revokimi i vendimit date 25.08.2004 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise. Kthimi i kapitalit ne vleren dhe masen qe gjendej para mbledhjes se asamblese se ortakeve date 25.08.2004.

Te behen ndryshimet ne kollonen 4 te Regjistrit Tregtar. Te behet ndarja me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

GJYQTARI
Mariunda Dogjo